



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVES PER DREJTESI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT	
BILANCI I GJENDJES	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	3
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	4
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	5 - 18



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2018, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare të Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të fondacionit më 31 Dhjetor 2018, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizaës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.

I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimin të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Kompanisë.

I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.

Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

ACA - Audit & Consulting Associates


ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
Mars, 2019



INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Bilanci i gjendjes
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

	Shënimi	Më 31 Dhjetor 2018 (në EUR)	Më 31 Dhjetor 2017 (në EUR)
ASETET			
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe paisjet		-	-
Totali i asetëve jo-qarkulluese		-	-
Asetet qarkulluese			
Llogaritë e arkëtueshme	3	61,596	-
Të arkëtueshmet tjera		-	-
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	4	82,961	50,667
Totali i asetëve qarkulluese		144,556	50,667
TOTALI I ASETËVE		144,556	50,667
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet rrjedhëse			
Obligimet ndaj donatorit		-	11,662
Ll. e pagueshme dhe shpenzimet akruale	5	26,407	3,827
Të hyrat e shtyera	6	118,149	35,178
Totali i detyrimeve rrjedhëse		144,556	50,667
Ekuiteti			
Fitimi i mbajtur		-	-
Profit/Humbja neto e vitit		-	-
Totali i ekutetit		-	-
TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT		144,556	50,667

Pasqyrat financiare janë nënshkruar më 15 mars 2019 nga:



Ehat Miftaraj
Drejtore Ekzekutiv

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Pasqyra e të ardhurave
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

	Shënimi	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2018 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2017 (në EUR)
Të hyrat			
Të hyrat nga grantet	7	325,564	249,411
Totali i të hyrave		325,564	249,411
Shpenzimet			
Pagat - Menaxhmenti dhe Administrata	8	56,531	38,052
Pagat - Stafit për Aktivitetet Programore	8	169,944	138,016
Shpenzimet e produksionit	9	32,259	25,179
Shpenzimet tjera operative	10	66,830	48,165
Totali i shpenzimeve		325,564	249,411
Teprica e të hyrave ndaj shpenzimeve		-	-

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

	Mbetja (në EUR)	Totali i mbetjes (në EUR)
Gjendja fillestare më 1 Janar 2016	-	-
Mbetja e fundit të vitit më 31 Dhjetor 2016	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	<u>-</u>	<u>-</u>
Mbetja e fundit të vitit më 31 Dhjetor 2017	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	<u>-</u>	<u>-</u>
Mbetja e fundit të vitit më 31 Dhjetor 2018	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	<u>-</u>	<u>-</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2018 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2017 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
(Deficiti)/surplusi gjatë periudhës	-	-
Rregulluar për:		
Zhvlersimin	-	-
	-	-
Obligimet ndaj donatorit	(11,662)	-
Ndryshimet në të arkëtueshme	(61,596)	-
Ndryshimet në të pagueshme	22,581	932
Ndryshimet në detyrime tjera	82,971	29,950
Paratë e gjeneruara nga operimet	32,294	30,882
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	-	-
Paraja neto e përdorur në investime	-	-
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	32,294	30,882
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	50,667	19,785
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	82,961	50,667

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

1. HYRJE

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) është organizatë e pavarur joqeveritare dhe jofitimprurëse, fabrikë e mendimeve e specializuar në fushën e drejtësisë, që merret me avancimin e së drejtës. I themeluar më 4 shkurt të vitit 2009, instituti funksionon si shoqatë profesionale, e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike me numër 5112193-7 në krye të së cilës qëndron Kuvendi i Anëtarëve. Veprimtaria e IKD-së udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv, i cili këshillohet nga Bordi Këshillëdhënës i organizatës.

Misioni i IKD-së është forcimi i sundimit të ligjit dhe përmirësimi i qasjes në drejtësi për qytetarët.

Vizioni i IKD-së është konsolidimi i shoqërisë me vlera demokratike, e cila respekton dhe promovon parimet e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë.

Qëllimi i IKD-së është avancimi i vazhdueshëm i së drejtës në Kosovë. Këtë qëllim synojmë arrijmë përmes veprimtarisë sonë hulumtuese, publikuese e avokuese, të cilën e organizojmë në gjashtë programe që na mundësojnë një qasje gjithëpërfshirëse të intervenimit, prej bërjes së ligjeve e deri te zbatimi i tyre nga institucionet përgjegjëse.

Veprimtarinë e vet, instituti e zhvillon përmes strukturës programatike. 1) Bërja e ligjit; 2) Sundimi i Ligjit; 3) Antikorrupsioni; 4) Drejtësia në zgjedhje; 5) Edukimi dhe 6) Media.

Qasja dhe parimet

Duke u siguruar se ligji i vendit bëhet përmes një procesi transparent e gjithëpërfshirës dhe zbatohet përmes një sistemi efikas të përgjegjësive dhe llogaridhënies të institucioneve të drejtësisë, IKD ndërton bazën e veprimeve të saj drejt qëllimit institucional. Përmes programeve specifike për drejtësi në zgjedhje dhe kundër korrupsionit, këto veprimtari sintetizohen në një qasje gjithëpërfshirëse drejt avancimit të drejtësisë në Kosovë, qasje të cilën e kompletojmë përmes aktiviteteve tona edukative e vetëdijësuese.

IKD vazhdimisht boton raporte që dalin nga puna jonë hulumtuese e monitoruese, natyra e të cilave shtrihet përgjatë gjithë spektrit të së drejtës, prej emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, te reformat e sistemit të drejtësisë, e deri te llogaridhënia brenda këtij sistemi.

Parimet që e udhëheqin veprimtarinë tonë janë saktësia, transparenca dhe llogaridhënia.

Aktivitetet e IKD-së

Instituti i Kosovës për Drejtësi, në veprimtarinë e tij, ndërmerr këto aktivitete:

Hulumtim ligjor, ku përfshihet, mes tjerash, hulumtimi i politikave publike që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, analiza cilësore dhe krahasuese të ligjeve dhe politikave publike, analiza krahasuese mes Kosovës, Rajonit dhe Evropës.

Hulumtim gazetaresk, ku përfshihet identifikimi i çalimeve, praktikave të këqija, mosrespektimit të rregullave dhe procedurave si dhe hulumtime tjera të rasteve të veçanta, që janë me interes për publikun.

Analizë dhe ekspertizë ligjore, përfshirë përkrahjen ligjore dhe teknike për institucionet e sundimit të ligjit.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

Avokim, përfshirë avokimin e drejtpërdrejt tek institucionet, avokimin përmes medias, mobilizimin e sektorit të juristëve dhe të shoqërisë civile për çështje të interesit të veçantë.

Raportimin, përfshirë raportimin televiziv dhe atë të shkruar online, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e sistemit të sundimit të ligjit, informimin e qytetarëve për këtë sistem, funksionimin dhe reformimin e tij, me fokus të veçantë përmirësimin e qasjes në drejtësi.

Monitorimin sistematik të punës së institucioneve të sundimit të ligjit, përfshirë policinë, prokurorinë, gjykatat si dhe Odën e Avokatëve, si dhe nxjerrjen e raporteve periodike dhe atyre të veçanta që dalin nga procesi i monitorimit.

Përkrahja e vazhdueshme teknike dhe substanciale e institucioneve të Republikës, përmes pjesëmarrjes aktive në grupet punuese për nisjen dhe amendamentimin e legjislacionit, si dhe grupeve tjera profesionale, duke u nisur nga faza e koncept dokumenteve e deri te revidimet e ligjeve në Kuvend.

Përfaqësimin e komunitetit të juristëve dhe të shoqërisë civile, në proceset legjislative dhe luajtjen e rolit të urës ndërlidhëse mes sistemit të sundimit të ligjit dhe shoqërisë.

Promovimi i vazhdueshëm i parimeve të ndarjes së pushteteve, promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut me fokus të veçantë në të drejtat përgjatë procedimeve në sistemin e drejtësisë.

Promovimi i rolit të pushtetit gjyqësor me fokus të veçantë në informimin për rolin e prokurorëve dhe gjyqtarëve si dhe institucioneve të pushtetit gjyqësor si KGJK dhe KPK.

Nxitjen e funksionimit të institucioneve të sundimit të ligjit, përfshirë këtu nxitjen për transparencë, sistem funksional të llogaridhënies dhe mbajtjes në përgjegjësi, si dhe bashkëpunimin mes institucioneve të sundimit të ligjit.

Vlerësimin e zbatimit të politikave dhe ligjeve, përfshirë ligjet, strategjitë, planet e veprimit dhe dokumenteve tjera politike sa i përket sundimit të ligjit.

Organizimi i debateve, qoftë debateve të brendshme mes institucioneve dhe akterëve, qoftë tryezave publike apo debateve televizive, për çështjet të rëndësishme në fushën e sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor.

Produktet e IKD-së

Instituti i Kosovës për Drejtësi, pos produkteve ad-hoc dhe të rastit, prodhon këto produkte të vazhdueshme:

- Raportet periodike të monitorimit të gjykatave
- Raportet periodike të monitorimit të prokurorive
- Raportet periodike të monitorimit të policisë
- Raportet e detajuara të procedimit të rasteve të korrupsionit
- Raportet e detajuara të procedimit të rasteve të veprave penale karakteristike
- Raportet e detajuara të procedimit të rasteve civile

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

- Raportet e detajuara të procedimit të rasteve administrative
- Hulumtime dhe analiza të politikave publike sa i përket sundimit të ligjit, specifikisht sistemit të drejtësisë dhe luftës kundër korrupsionit
- Reagime të shpejta publike për çështje të caktuara
- Analiza të ligjeve dhe pajtueshmërisë së tyre me standardet e BE-së dhe OKB-së
- Konstruktimi i platformës së burimeve të informacionit, statistikave dhe të dhënave tjera, që dalin si rrjedhojë e punës së IKD-së (dhe jo vetëm) të cilat botohen në një faqe të veçantë interneti dhe shërben si burim primar për hulumtues dhe gazetarë.
- Raporte gazetareske ditore për seancat gjyqësore
- Lajme të përditshme për sistemin e sundimit të ligjit
- Analiza të lajmeve në baza të përjavshme
- Raporte hulumtuese, gazetareske, sa i përket sundimit të ligjit
- Emisionin televiziv të specializuar në fushën e sundimit të ligjit “Betimi për Drejtësi”

Ekipi i IKD-së

Personeli i IKD-së ka përvojë të madhe në kapacitete të ndryshme në sektorin e drejtësisë në Kosovë, duke përfshirë zhvillimin e hulumtimeve dhe analizave ligjore, raportimet dhe hulumtimet gazetareske, ngritjen e vetëdijes, dhe përfshirjen në aktivitete të avokimit. Këtu përfshihet puna e ngushtë me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë për të siguruar pavarësi, paanshmëri dhe ngritje të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

2. ADAPTIMI I STANDARTEVE TË RISHIKUARA DHE STANDARDEVE TË REJA

2.1 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet efektive në këtë periudhë

Më poshtë janë paraqitur ndryshimet në standardet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar të cilat janë në fuqi për periudhën aktuale:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
Amandament në SNRF 10	Pasqyrat Financiare të Konsoliduara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNRF 11	Dhënia e informacioneve shpjeguese tek subjektet tjera të interesit – udhëzues i Tranzicionit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNRF 12	Dhënia e informacioneve shpjeguese tek subjektet tjera të interesit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 1	Prezentimi i pasqyrave financiare	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 7	Iniciativa të shpalesjeve	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017
Amandament në SNK 12	Njohja e tatimeve të shtyra për Humbjet e perealizuara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017
Amandament në SNK 16	Sqarime të metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 27	Ndryshime për të rivendosur metodën e ekuitetit si opsion kontabël në pasqyrat e ndara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 28	Ndryshimet në lidhje me shitjen ose kontributin e aseteve në mes të një investitori, bashkëpunëtori apo joint venture	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 38	Asetet e paprekshme	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 41	Impiantet bartëse	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandamentimet në standarde të ndryshme	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2012-2014) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janar 2016
Amandamentimet në standarde të ndryshme	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2012-2014) - që rezultojnë nga	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2014

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

	Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 2, SNRF 2, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	
Amandamentimet në standarde të ndryshme	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2011-2013) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Korrik 2014

2.2 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet jo efektive në këtë periudhë

Në këto pasqyra financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme akoma nuk janë efektive:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
SNRF 1	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2014-2016) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor, kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 2	Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave të ndara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 3	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2015-2017) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor, kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 9	Versioni i finalizuar, duke përfshirë kërkesat për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin, kontabilitetin e përgjithshëm rreth investimit dhe mosnjohjen.	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 9	Vetitë e parapagimive me kompensim negativ dhe modifikimet e detyrimeve financiare	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 11	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2015-2017) - (rivlerësimi i interesit të mbajtur më parë)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

SNRF 15	Sqarime rreth SNRF 15	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 16	Qeratë	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 17	Qeshtje Origjinale	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2021
SNK 12	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2015-2017) - (pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNK 19	Amandement në lidhje me ndryshimet në planifikim, kufizimet ose rregullimet	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNK 23	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2015-2017) - (kostot e huamarrjes të pranueshme për kapitalizim)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNK 28	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2014-2016) - (qartësim i matjeve të vlerës së drejtë)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNK 28	Amandement në lidhje me interesin afatgjatë në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta – Joint Venture	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNK 40	Amandament për të sqaruar transferimet ose pasurinë në pronën e investimit, ose nga prona e investimit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018

Organizata ka vendosur të mos i adaptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Organizata parashikon që adaptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të subjektit në periudhën e zbatimit fillestar.

BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.3 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të bashkangjitura janë përgatitur për qëllime të raportimit në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe paraqesin një pasqyrë të plotë të ngjarjeve ekonomike që kanë ndodhur në Institutin e Kosovës për Drejtësi – IKD më 2018.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parave të gatshme, në bazë të cilës të ardhurat dhe shpenzimet njihen në momentin kur janë pranuar apo paguar. Organizata përdor programin e financave QuickBooks dhe fajlla të Excell-it për regjistrimet financiare dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.4 Valuta e përdorur

Valuta e përdorur për raportim nga ana e Institutit të Kosovës për Drejtësi – IKD është valuta e bashkësisë evropiane Euro (“EUR”).

2.5 Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

Një përmbledhje e politikave më të rëndësishme të kontabilitetit të përvetsuara për pregaditjen e pasqyrave financiare janë prezentuar më posht:

2.5.1 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, parja dhe ekuivalentet e parase janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shumë se tre muaj.

2.5.2 Njohja e të hyrave

Të hyrat nga grantet janë njohur si të hyra për periudhën të cilës i takojnë. Në fund të vitit mbetja e të ardhurave mbi shpenzimet trajtohet si suficit.

2.5.3 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet e ndodhura për gjenerimin e të hyrave janë njohur në periudhën përkatëse në bazë të kostos historike.

2.5.4 Tatimet

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD është e regjistruar si organizatë jo-profitabile nën rregulloret e Kosovës, dhe e posedon statusin e beneficuar si OJQ, prandaj është e përjashtuar nga tatimi mbi korporata mbi të tepricën e të hyrave ndaj shpenzimeve.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

3. LLOGARIT E ARKETUESHME

	31 Dhjetor 2018 (në EUR)	31 Dhjetor 2017 (në EUR)
Abasada Britaneze	12,366	-
Abasada Amerikane INL	49,229	-
Totali I Llogarive te Arketueshme	61,596	-

4. PARAJA DHE GJENDJA NË BANKA

	31 Dhjetor 2018 (në EUR)	31 Dhjetor 2017 (në EUR)
Paraja e gatshme	-	-
Paraja në bankë:	82,961	50,667
Totali parasë dhe gjendjes në bankë	82,961	50,667

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD ka nëntë (9) llogari bankare në EUR të hapura në Bankën për Biznes – BpB dhe një (1) llogari që operon në USD që shërben vetëm për pranimin e donacioneve në USD.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

5. LLOGARITË E PAGUESHME DHE SHPENZIMET AKRUALE

	31 Dhjetor 2018 (në EUR)	31 Dhjetor 2017 (në EUR)
Tatimi në të hyra	-	-
Pensionet	3,499	-
Pagat	16,788	-
Shpenzimet e qeras	550	-
Sherbimet tjera	-	453
PTK Telekom	340	-
BPB	64	-
HIB Petrol	427	-
NSH Fonia	1,133	-
Golden Taxi	1,075	-
Norwegian PX Kosovo shpk	89	-
Shpenzime te zyres	-	294
Rikon NTSH	25	-
Anymate	2,019	-
Kutia	82	3,080
Shpenzimet për rrymë elektrike KESCO	304	-
Shpenzimet për ujë K.U.R	13	-
Totali i llogarive të pagueshme dhe shpenzimeve akruale	26,407	3,827

6. TË HYRAT E SHTYERA

	31 dhjetor, 2018 (në EUR)	31 dhjetor, 2017 (në EUR)
Radio Televizioni i Kosoves - RTK	19,307	13,632
Instituti Demokratik I Kosoves - KDI	-	-
UNOPS	-	1,288
Java Kunder korupsionit	4,435	11,598
NED	6,291	8,661
Ambasada Amerikane	-	-
KCSF	5,000	-
MATRA	43,166	-
FOL	407	-
INL USA	39,543	-
Totali i te hyrave te shtyera	118,149	35,178

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

7. TË HYRAT

	31 Dhjetor 2018 (në EUR)	31 Dhjetor 2017 (në EUR)
Ambasada Britanike - Projekti Antikorrupsion I	50,763	41,291
Ambasada Britanike - Projekti Antikorrupsion II	109,300	104,306
NCSC	-	49,809
Radio Televizioni i Kosovës - RTK	33,633	29,567
Ambasada Amerikane	-	1,819
UNOPS	28,088	5,307
Instituti Demokratik i Kosovës - KDI	1,640	198
NED	32,784	27,038
Java kunder korupsionit	41,908	18,574
Ambasada Amerikane - Zgjedhjet	-	6,681
INL US EMBASSY	49,229	-
FOL	1,000	-
KCSF	45,368	-
MATRA	50,000	-
Të hyrat tjera	-	-
Të hyrat e shtyera	(118,149)	(35,178)
	-	-
Totali i të hyrave nga grantet	325,564	249,411

8. PAGAT DHE BENEFITET

Pagat për Menaxhmentin dhe Administratën e organizatës gjatë vitit 2018 janë realizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018 (në EUR)	31 Dhjetor 2017 (në EUR)
Pagat bruto	53,839	36,240
Kontributet Pensionale	2,692	1,812
Totali i pagave - Menaxhmenti dhe Administrata	56,531	38,052

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

Ndërsa pagat për stafin e angazhuar në aktivitetet e ndryshme programore gjatë vitit 2018 janë realizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018 (në EUR)	31 Dhjetor 2017 (në EUR)
Pagat bruto	161,851	131,629
Kontributet Pensionale	8,093	6,387
Totali i pagave - Stafi per Aktivitetet Programore	<u>226,474</u>	<u>138,016</u>

9. SHPENZIMET E PRODUKSIONIT

OJQ Institutiti i Kosovës për Drejtësi – IKD mban në Radio Televisionin e Kosovës – RTK një herë në javë emisionin “Betimi për Drejtësi”. Për këtë shkak organizata e ka kontraktuar kompaninë “Anymate” për t’i kryer punët e produksionit në mënyrë që programi të jetë gati për emetim televiziv. Gjithashtu, gjatë këtij viti kompania “Anymate” është kontraktuar për të kryer shërbime të tjera për produkte të ndryshme të dizajnit dhe produkte mediale në kuadër të projekteve të tjera si promo dhe dokumentar.

	31 Dhjetor 2018 (në EUR)	31 Dhjetor 2017 (në EUR)
Shpenzimet e produksionit	32,259	25,179
Totali i shpenzimeve te produksionit	<u>32,259</u>	<u>25,179</u>

10. SHPENZIMET TJERA OPERATIVE

	31 Dhjetor 2018 (në EUR)	31 Dhjetor 2017 (në EUR)
Shpenzimet per Ueb	-	6,549
Konsulenca	697	
Tryeza dhe konferenca	14,344	9,750
Qeraja	6,600	6,452
Auditimi	800	490
Transporti	10,209	8,957
Shpenzimet e komunikimit (telefon, internet)	5,339	4,430
Shpenzimet komunal (rryma, uji, bërlloku)	1,793	2,124
Paisje për zyre (llop top, rafta, tavolina)	2,601	3,650
OJQ	16,218	-
Perkthimi	3,605	-
Shpenzimet e zyres dhe tjera	4,625	5,764
Totali i shpenzimeve tjera operative	<u>66,830</u>	<u>48,165</u>

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

Shenime shpjeguese për të hyrat nga RTK – ja, për projektin “Betimi për Drejtësi”.

	31 Dhjetor 2018 (në EUR)
Llogari e arketueshme	73,400
Totali I llogaris se arketueshme nga RTK	73,400

Përshkrimi	Vlera
Të faturuara në 2018	18,700.00
Të paguara në 2018	20,000.00
Obligimi 2018	(1,300.00)
Obligimi 2017	74,700.00
Totali I obligimit deri me 31.12.2018	73,400.00
Te shpenzuara në 2018	14,326.34
Mbetja nga 2017	13,632.72
Mbetja 31.12.2018 Të hyrat e shtyra	19,306

Në bazë të tabelës së mësipërme, rezulton se IKD ka faturuar RTK-në për 18,700 euro. Ndërkaq, RTK, kanë paguar 20.000.00 euro. Nga kjo shihet se pagesa është më e madhe se borxhi për 1,300 euro. Por, borxhi i RTK-së ndaj IKD-së nga viti 2017 është 74,700 euro dhe kur këtij borxhi ja zbrisim 1,300 euro nga pagesa e vitit 2018 borxhi total me 31.12.2018 rezulton të jetë 73.400.00 euro.

IKD këtë borxh nuk e njeh si të hyrë, por vetëm e evidenton si faturim, ndërsa në momentin që kryhen pagesat nga RTK, atëherë njihen si të hyra.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI - IKD
Shënimet e pasqyrave financiare
Për fundin e vitit më 31 dhjetor 2018

11. PASQYRA E TË ARDHURAVE SIPAS DONATORËVE

	Ambasada Britaneze - Antikorrupsioni I	Ambasada Britaneze - Antikorrupsioni II	Java kunder korrupsionit 2017	Java kunder korrupsionit 2017	INL Ambasada Amerikane	UNOPS 2017	UNOPS	KDI	RTK	NED 2017	NED	FOL	KCSF 2019	KCSF	MATRA	Tjera	Totali
Të hyrat	50,763	109,300	-	30,311	49,229	-	26,800	1,640	20,000	2,783	21,342	1,000	5,000	40,368	50,000	-	408,535
Të hyrat e shlyera nga viti i kaluar	-	-	11,598	-	-	1,288	-	-	13,633	8,660	-	-	-	-	-	-	35,178
Të hyrat e shlyera	-	-	-	(4,435)	(39,543)	-	-	-	(19,306)	-	(6,291)	(407)	(5,000)	-	(43,167)	-	(118,149)
Totali të hyrave	50,763	109,300	11,598	25,875	9,686	1,288	26,800	1,640	14,327	11,442	15,051	593	40,368	40,368	6,833	-	325,564
Shpenzimet																	
Pagat dhe benefitet	34,239	83,799	2,059	4,011	8,288	-	26,680	1,631	13,000	7,531	13,475	-	-	28,560	3,200	-	226,474
Shpenzimet e produksionit	6,115	12,169	5,052	765	-	-	-	-	-	2,016	-	-	-	6,142	-	-	32,259
Shpenzimet per Ueb	697	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	697
Tyreza dhe konferenca	2,345	-	1,757	4,833	-	-	-	-	-	273	-	-	-	5,135	-	-	14,344
Qeraja	1,650	4,400	-	-	351	-	-	-	199	-	-	-	-	-	-	-	6,600
Auditimi	-	-	-	-	-	800	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	800
Transporti	2,488	5,568	-	-	721	-	-	-	70	609	430	-	-	322	-	-	10,209
Shpenzimet e komunikimit (telefon, internet)	1,435	2,910	-	-	-	-	-	-	50	455	370	-	-	119	-	-	5,339
Shpenzimet komunali (rryma, uji, bërthok)	1,104	-	-	-	304	-	-	-	26	25	334	-	-	-	-	-	1,793
Pasje për zyre (llop top, rafta, tavolina)	-	-	2,153	-	-	80	-	-	100	-	-	268	-	-	-	-	2,601
OJQ	-	-	-	16,218	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	16,218
Transiate	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3,605	-	3,605
Shpenzime tjera	690	453	577	48	22	408	120	9	881	532	442	325	-	90	30	-	4,625
Total i shpenzimeve	50,763	109,300	11,598	25,875	9,686	1,288	26,800	1,640	14,327	11,442	15,051	593	40,368	40,368	6,833	-	325,564
Teprica e të hyrave ndaj shpenzimeve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

12. PALËT E NDËRLIDHURA

Për qëllime të këtyre pasqyrave financiare, palët konsiderohen të ndërlidhura nëse njëra prej tyre ka mundësinë të kontrolloj palën tjetër, apo nëse njëra prej tyre ka ndikim në palën tjetër gjatë marrjes së vendimeve financiare apo operuese sic është cekur në SNK 24 "Shpalosja e palëve të ndërlidhura". Në vështrimin e mundësisë së ekzistimit të palëve të ndërlidhura, vëmendja është përqëndruar në aspektin e marrëdhënies e jo në aspektin legal.

13. MENAXHIMI I RISKUT

Kredit risku

Kredit Risku është risku që njëra palë me dështimin në përmbushjen e obligimeve financiare do ndikojë në palën tjetër të ketë humbje financiare. Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD nuk i është ekspozuar kredit riskut në aspektin e granteve që i ipen organizatave me të cilat bashkëpunon.

Risku nga kamatat

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD momentalisht nuk i është ekspozuar riskut nga kamatat bankare.

Risku nga këmbimet ndërkombëtare

Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD i është ekspozuar nga këmbimet ndërkombëtare pasi që transaksionet ndodhin në valutë vendore dhe të huaj.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit paraqet riskun kur pjekuria e pasurisë dhe e detyrimeve nuk përputhen. Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD monitoron likuiditetin e sajë në baza periodike, në mënyrë që të menaxhoj obligimet e sajë në momentin kur duhet të paguhen.